



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 25.09.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 23.09.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Erik SHPK" për aktivitetin: "Pastrimi i shkollave fillore 'Gjergj Fishta', 'Ismajl Qemali', 'Asim Vokshi', 'Dardania', 'Naim Frasheri', 'Pjeter Bogdani', 'Shkola e Gjelbert' dhe 'Mehmet Xhevorit' dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3237-211 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "ERIK SHPK" e datës 23.09.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore 'Gjergj Fishta', 'Ismajl Qemali', 'Asim Vokshi', 'Dardania', 'Naim Frasheri', 'Pjeter Bogdani', 'Shkola e Gjelbert' dhe 'Mehmet Xhevorit' dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3237-211, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 17.09.2019*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 17.09.2019;**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "ERIK SHPK" me datë 23.09.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi i shkollave fillore 'Gjergj Fishta', 'Ismajl Qemali', 'Asim Vokshi', 'Dardania', 'Naim Frasheri', 'Pjeter Bogdani', 'Shkola e Gjelbert' dhe 'Mehmet Xhevorit' dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3237-211. Autoriteti Kontraktues, me datë 24.09.2019 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara si vijon:

-Pretendimet se tenderuesi i propozuar për dhenje të kontratës nuk është i përgjegjshëm nuk janë të bazuara, pasi që në tenderin e të njëjtit dhe në sqarimet plotësuese mund të vereni se janë të gjitha deshmite e kerkuara, duke përfshirë edhe listen e

kontratave,çertifikatat,deklarimet dhe referencat me vlera nga Institucionet publike.Plotesimet dhe sqarimet e kerkuara nga OE-ik jane ne harmoni me nenin 72 te LPP-ik dhe nenin 39.8 te RRUOPP-se si dhe me kerkesat e dosjes se tenderit ;

-Lidhur me pretendimet se konzorciumi "SAF SHPK&INTEGRAL" nuk i plotesojne kerkesat e dosjes,respektivisht nuk kane deshmi per kryerjen e sherbimeve te njejta,poashtu nuk qendron sepse ky konzorcium nuk ka deshmi per asfaltim te rrugeve,por ka edhe deshmi per mirembajtje dhe pastrim te rrugeve e qe eshte sherbim i ngjajshem me sherbimet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktues.

-Lidhur me pretendimet ndaj OE-ik "Laguna"poashtu theksojme se ka deshmi te mjaftueshme qe deshmojne plotesimin e kerkesave te dosjes se tenderit dhe si te tilla jane te pa bazuara.

-Pretendimet per mungesen e deklarimeve te disa tenderueseve poashtu jane te pa bazuara dhe nuk kane rendesi edhe nese ndonje nga te njejtat mungon,pasiqe me momentin e konkurimit çdo tenderues eshte i vetedijshem se ato do te jene pjese e kushteve te veçanta te kontrates;

-Pretendimet tjera te ketij ankuesi kane te bejne me analize financiare,poashtu jane te pa bazuara sepse çmimi i tenderuesit te propozuar per kontrate dhe te tenderueseve tjere te cekur e plotesojne kerkesen baze te Autoritetit kontraktues,i cila ka parapare qe ne çmim duhet te perfshihen te ardhurat(pagat)bruto te punetoreve ne vlere prej 282,50 euro,ne te cilen eshte perfshire edhe rritja prej 4%,dhe e cila permban te gjitha detyrimet financiare qe rrjedhin nga kalkulimi i pagave dhe pervoja e punes ne vlere prej 1.390.00 euro dhe ne fund normalisht TVSH-ja si obligim ligjor per çdo OE-ik qe shfrytezon mjetet nga kontratat publike. Nga kerkesa jone rrjedh se çmimi me i ulet i pranueshem per AK-ne eshte si vijon:282,50x83 punetor=23,447.50 euro ne muaj plus pervoja e punes ne vlere mujorer prej 1.390.00 euro e qe paraqet çmimin total mujor prej 24,837.50 €uro ne muaj.Ky çmim per periudhen 36 mujore eshte 894,150.00 euro dhe kur i shtohet TVSH-ja prej 18%-160,947.00 euro na jep çmimin total per tere periushen prej 1,055,097.00 euro e qe rezulton se çmimi i dhene nga tenderuesi eshte mbi kete çmim dhe e ploteson kete kerkese.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit